

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Raport Vjetor 2019



TABELA E PËRMBAJTJES

1	PARATHËNJE	
	Observatori 7 vite prezent në Shqipëri.....	2
2	PROJEKTE 2019	
	Monitorimi i të drejtave të fëmijëve me fokus fëmijët jashtë shkolle në Shqipëri	4
	Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë- Program Rajonal.....	6
	Programi “Zëri i të Rinjve”	7
	Lufta ndaj ngacmimit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri...9	
	Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve	10
3	PARTNERËT E OBSERVATORIT	
	Kontributi i Partnerëve.....	11

» PARATHËNJE

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve


Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në Shqipëri është një entitet joqeveritar i themeluar në 2013 si një rrjet i shoqërisë civile që synon të monitorojë situatën e fëmijëve dhe të rinjve në nivel kombëtar dhe strategjik. Degët e Observatorit janë në të gjithë vendin duke pasur dymbëdhjetë ekspertë rajonale (një në secilën bashki kryesore të vendit). Një staf i kualifikuar dhe me përvojë që ndodhet pranë çdo lokaliteti na jep mundësinë për të monitoruar situatën e fëmijëve e të rinjve dhe çështjet e të drejtave deri në nivel lokal.

Misioni ynë është të sigurojmë dinjitetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve në të gjithë Shqipërinë përmes vëzhgimit, kërkimit dhe analizës, komunikimit dhe avokimit; duke bashkëpunuar me aktorët / institucionet e tjera; dhe duke u përfshirë në fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi të publikut.

Përmes përfaqësuesve të tij në nivelin rajonal dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në bashki, Observatori mbledh informacionin statistikor nga të dhënat administrative të shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes sociale dhe autoriteteve të tjera vendore. Duke përdorur softëerin DevInfo pasuria e informacionit statistikor është konsoliduar në një bazë të dhënash të disponueshme online në: <http://observator.org.al/odf2/qarqet-en.html>.

Deri më tani, baza e të dhënave të siguruara nga Observatori ka shërbyer si një burim unik informacioni në hartimin e një sërë ndërhyrjesh në nivel kombëtar dhe lokal nga institucione të ndryshme publike dhe OJF, si dhe ka shërbyer në planet e ndryshme strategjike të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare.

Duke përdorur këto të dhëna të marra nga institucione të ndryshme në nivel qendror dhe lokal, Observatori ka realizuar monitorime dhe vlerësime të ndryshme mbi situatën e fëmijëve dhe të rinjve në vend, duke kontribuar në hartimin e planeve të veprimit për fëmijët dhe të rinjtë në nivel kombëtar dhe lokal.



Një kontribut i rëndësishëm i prezencës së fortë të Observatorit në terren është aftësia e tyre për të advokuar me autoritetet qeveritare për të zgjeruar masat qendrore dhe lokale për adresimin e nevojave të fëmijëve dhe të rinjve në vend.



Përgjatë këtyre 5 viteve, Observatori ka qenë një nga nismëtarët dhe mobilizuesit e ngritjes dhe fuqizimit të rrjetit “Zëri I të rinjve”, duke mundësuar adresim politikash vendore për të rinjtë si dhe mbështjetës të aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare me dhe për të rinjtë.

Observatori është entiteti i parë dhe i vetëm në Shqipëri që ka ngritur zërin dhe ka ndërmarrë katër vjet angazhim intensiv në bërjen publike të çështjes së martesave nën moshë për të shpëtuar jetën e vajzave dhe djemve; Duke ngritur zërin nga nismat për ndërgjegjësimim në nivel lokal, deri në vëmendjen dhe politikën e qeverisë qendrore, duke e bërë pjesë të tryezave të diskutimit me përfaqësuesit e Ministrive të linjës.

Përmbajtja e këtij Raporti është përgjegjësi e Observatorit.

© Aplikimet për leje për të shumëfishuar ose përkthyer pjesë nga ky publikim duhet të dërgohen në:
Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Rruga “Brigada e VIII”, Pall. LID, K.1, Z.1, Tiranë, Shqipëri
Email: info@observator.org.al
Webmail: www.observator.org.al

» PROJEKTE 2019

Monitorimi i të drejtave të fëmijëve me fokus fëmijët jashtë shkollë në Shqipëri

Përgjatë vitit 2019, Observatori, në partneritet me UNICEF Albania, ka vijuar zbatimin e programit “**Cdo fëmijë në shkollë**”, i cili përgjatë këtij viti është orientuar në drejtim të zbatimit të:

- Monitorimit që çdo fëmijë të shkojë në shkollë.
- Monitorimit dhe raportimit të të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar dhe lokal;

Ndërsa pjesa më e madhe e fëmijëve të moshës shkollore të detyrueshme në Shqipëri ndjekin shkollën, disa mbeten të përjashtuar nga arsimit për shkak të faktorëve komplekse dhe mbivendosës, siç janë migrimi, varfëria ekstreme, aftësia e kufizuar, qëndrimet prindërore ose praktikat kulturore, çështjet e gjuhës ose rrethanat e vështira familjare. Gjatë viteve të fundit, Observatori së bashku me UNICEF-in, dhe në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) kanë punuar në çështjen e fëmijëve jashtë-shkollës me partnerë të ndryshëm, duke mbështetur funksionimin e një mekanizmi për identifikimin e fëmijëve (6 deri në 8 vjeç) që nuk kanë filluar me kohë arsimin e detyruar dhe regjistrimin e tyre në shkollë. Nisma po realizohet në Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër. Për herë të parë, në kuadër të zbatimit të kësaj nisme, qeveria shqiptare ka alokuar një **fond të veçantë për mbështetjen me bursa të fëmijëve** që nuk shkojnë në shkollë për shkak të vështirësive dhe pamundësive ekonomike. Për këtë qëllim, në **10.10.2019 u miratua VKM nr 666** “Për kuotat financiare dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”. Fondi i vënë në dispozicion në MASR është për **mbështetjen e rreth 600 fëmijëve në nivel kombëtar** me qëllim integrimin e tyre në shkollë.



Nëpërmjet kësaj nisme janë kontaktuar mbi **2000 ofrues shërbimesh të linjës së parë** në lidhje me detyrat dhe afatet që duhet të përmbushen nga secili për arsimimin e cdo fëmijëve. Nëpërmjet takimeve në terren me prindërit e grupeve të marxhinalizuara (të papunë, në ndihmë ekonomike, me aftësi të kufizuara, nga komunitetet Rome dhe/ apo Egjiptiane) dhe përfaqësuesve mediatike (media vizive dhe sociale) janë arritur mbi **15,000 individë**.

Nisma “**Cdo fëmijë në shkollë**” përgjatë vitit 2019 është dokumentuar nëpërmjet një videoje, që sjell këndvështrimin mbi zbatimin e nismës nga aktorë kyç për arsimimin e fëmijëve, si: MASR, UNICEF, Bashkia, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, shkolla. Videoja pasqyron gjithashtu dhe zërin e fëmijëve të mbështetur me bursa, dhe ndikimin që kjo mbështetje jep jo vetëm për të tashmen e fëmijëve, por për të

ardhmen dhe jetën e tyre. *Versioni i plotë i videos dokumentuese të nismës “Cdo fëmijë në shkollë”, gjendet në linkun e mëposhtëm:*

<https://www.youtube.com/watch?v=njglQdOpNAM&feature=youtu.be>.

Fokus gjatë kësaj periudhe është vendosur dhe në monitorimin e të drejtave të fëmijëve si në nivel kombëtar, ashtu dhe në nivel lokal.



Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 (Agjenda) në Shqipëri është dhe dokumenti kryesor që planifikon dhe parashikon masat, nismat dhe aktivitetet që lidhen me fëmijët në nivel qendror. Ajo gjithashtu përbën një instrument të rëndësishëm për të përmirësuar llogaridhënien e përgjegjësve të ndryshëm të qeverisjes së shtetit në zbatimin e veprimeve drejt realizimit progresiv të të drejtave të fëmijëve. Në fund të vitit 2018, Agjenda arriti gjysmën e zbatimit duke shfaqur si nevojë dhe monitorimin e zbatimit të saj si dhe riformulimin e saj sipas jo vetëm progresit të arritur, por edhe të subjektit të prioritetëve e reja. Në bashkëpunim me UNICEF, Observatori mundësoi përkrahje teknike të përkushtuar për Minitrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Agjensinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHDMF) në zhvillimin e instrumenteve të mbledhjes së të dhënave dhe kryerjen e analizës së informacionit për të informuar Draft Raportin Afatmesëm të Agjendës duke përfshirë dhe planin e zbatimit për periudhën e mbetur 2019-2020. Ky proces u realizua në bashkëpunim me të gjithë institucionet qendrore dhe bashkitë përgjegjëse për zbatimin e masave dhe

aktivitetëve të parashikuara në Agjendë të cilat raportuan sipas instrumentave të parapërgatitura. Informacioni i mbledhur gjatë këtij procesi u përdor për dizejnimin e raportit të monitorimit afatmesëm të Agjendës i cili mund të gjendet në: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2019/10/PRINT_raporti_final_shqip.pdf

Si risi gjatë këtij procesi ishte dhe angazhmi i fëmijëve dhe adoleshentëve në procesin e monitorimit dhe raportimit të Axhendës. Në total u organuan 7 aktivitete konsultuese me fëmijët në zona të ndryshme të Shqipërisë duke përfshirë gjithashtu dhe fëmijë nga grupe vulnerabël (Fëmijë me aftësi të kufizuara si dhe fëmijë në institucione përkujdesi).


Nga ana tjetër, fokusi gjithashtu u vu në nivel lokal. Ndërkohë që Bashkitë janë dhe institucioni përgjegjës për të koordinuar punën ndërmjet sektorëve të ndryshëm për çështje që lidhen me fëmijët si dhe për të relizuar monitorimin e zbatimit të të drejtave të tyre, mungesa e stafit të dedikuar në bashki si dhe mos-vartësia e



drejtpërdrejtë e institucioneve të tjera lokale nga bashkia e vështirësojnë këtë proces. Në bashkëpunim me UNICEF, Observatori, gjatë vitit 2019 ka asistuar dy bashki pilot (Shkodër dhe Korçë) për të mbledhur të dhëna dhe statistika nga sektorë të ndryshëm (demografia, shëndetësia, arsimi, mbrojtja sociale, fëmijët në kontakt me ligjin si dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna) për dy vite (2017 dhe 2018) duke i pajisur këto bashki me një dokument që paraqet situatën e fëmijëve në territorin e tyre.

Publikimet mund të gjenden:

- Për Bashkinë Korçë në: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2019/11/Korca-Shqip-final-14.10.2019.pdf>
- Për Bashkinë Shkodër në: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2019/11/Shkodra-Shqip-final-14.10.2019.pdf>



Për më tepër, nëpërmjet kësaj nisme u hodhën dhe hapat e parë për të draftuar një metodologji se si bashkitë mund të analizojnë situatën e fëmijëve në territorin e tyre.


Ashtu si në nivel qendror, dhe në nivel lokal, focus i veçantë iu kushtua dhe angazhimit të fëmijëve në vendimmarrje. Në të dyja bashkitë pilot (Shkodër dhe Korçë) u realizuan takime me stafin përgjegjës të bashkisë për të diskutuar mbi angazhimin e fëmijëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Në të dyja bashkitë, ky proces u konsiderua si i rëndësishëm dhe Observatori gjeti bashkëpunimin e bashkive për koordinimin e këtij procesi. Gjithashtu u realizuan takime konsultuese me fëmijët për të ngritur një metodologji për ngritjen e këshillëve të fëmijëve pranë bashkisë. I gjithë procesi u finalizua me dokumente (1 për secilën bashki) ku detajohen hapat e nevojshëm për ngritjen e këtyre këshillëve të fëmijëve në nivel lokal.

Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë - Program Rajonal

Observatori ka rritur gradualisht angazhimin edhe në çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri. Përgjatë vitit 2019, Observatori u angazhua në zbatimin e dy komponentëve të programit rajonal “Ndal Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave - Zbatojmë Normat, Ndryshojmë Mendësitë” (i zbatuar në: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Kosovë, Serbi dhe Turqi), si më poshtë:

- Mbledhjen e të dhënave për stereotipet gjinore dhe perceptimin e publikut për rolet gjinore dhe qëndrimet ndaj dhunës ndaj grave;
- Hartimin e një Plani Strategjik të Komunikimit për të adresuar dhunën ndaj grave në Shqipëri.

Programi u realizua në partneritet me UN Women në Shqipëri dhe me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit European.



Në këtë program rajonal, Observatori u angazhua në **mbledhjen e të dhënave mbi qëndrimet, perceptimet, opinionet dhe besimet publike aktuale dhe mbizotëruese ndaj barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje në nivel komuniteti**, përgjatë dy fazave të ndryshme:

- Faza e parë: Vlerësimi fillestar (Baseline: nëntor 2017 - prill 2018)
- Faza e dytë: Vlerësimi afatmesëm (Mid-Term Review: shtator - dhjetor 2019).

Përgjatë vitit 2019, u matën perceptimet dhe qëndrimet e **1260 individëve** - gra, vajza, burra, djem dhe të tjerë, të moshave **15 – 64 vjeç**, në **Qarkun e Elbasanit dhe bashkitë e Durrësit, Kamzës, Korçës, Shkodrës, Tiranës dhe Vlorës**, në zonat urbane dhe rurale, duke përfshirë dhe persona nga komunitetet e marginalizuara (Rome, Egjiptiane, personat me aftësi të kufizuara, dhe persona LGBTI).

Gjithashtu u intervistuan **19 aktorë punonjës të institucioneve kyç** (qendrore dhe lokale) për çështjet e dhunës në Shqipëri.

Gjetjet nga anketimet mbështesin Qeverinë Shqiptare dhe shoqërinë civile për zbatimin e masave më efektive në drejtim të parandalimit; rrisin nivelin e informacionit mbi qëndrimet dhe perceptimet e shoqërisë mbi stereotipet dhe rolet gjinore dhe dhunës ndaj grave, si dhe identifikojnë fushatat ndërjegjësuëse që kanë patur ndikim pozitiv në komunitet. Raporti i mbledhjes së të dhënave sasiore dhe cilësore në fazën e vlerësimit afatmesëm gjendet në linkun: <https://observator.org.al/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-Vleresimi-Afatmesem-Dhjetor2019.pdf>

Si komponent i dytë i këtij projekti ishte dhe “Hartimi i një Plani Strategjik të Komunikimit për të adresuar dhunën ndaj grave në Shqipëri”. Kjo iniciativë u zbatua në të njëjtat bashki ku studimi fillestar është realizuar, konkretisht në 6 bashki (Tiranë, Durrës, Korca, Shkodër, Vlorë, Kamëz) dhe 1 qark (Elbasan).

Në kuadër të këtij projekti u zhvillua një strategji komunikimi që synon ndryshimin e një sjelljeje specifike që lidhet me dhunën ndaj grave dhe vajzave. Në konsultim me institucionet qendrore dhe lokale u vendos që sjellja që do të targetohet do të jetë rritja e raportimit të dhunës si nga viktimat, ashtu dhe nga dëshmitarët. Pas një procesi të gjatë konsultimi u finalizua një plan i mirëfilltë



komunikimi i cili përfshin një objektiv specifik, hapat e nevojshëm për t'a arritur atë si dhe afatet përkatëse kohore.

Nga ana tjetër, si gjatë konsultimeve me institucionet lokale, me ofruesit e shërbimeve dhe nga vetë qytetarët u theksua si motivim për të raportuar dhunën dhe bindja e tyre se strukturat përgjegjëse do të manaxhonin rastet me efektivitet si dhe do të ofronin shërbimet e duhura për viktimat. Para se të motivohej raportimi i dhunës, lindi si nevojë dhe vlerësimi i mundësive dhe nevojave të institucioneve përgjegjëse për manaxhimin e rasteve të dhunës. Një vlerësim i tillë u realizua në kuadër të këtij projekti dhe u hartua një raport verësimi mbi nevojat e institucioneve lokale për të adresuar rastet e dhunës.

Programi “Zëri i të Rinjve”

Observatori në saj të partneritetit me zyrën e UNFPA-së në Shqipëri, është i angazhuar që prej vitit 2017 për zbatimin e programit Zëri i të Rinjve: “Për krijimin, koordinimin dhe zgjerimin e platformës mbrojtëse të shoqërisë civile për çështjet e ICPD dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)”. Në vitin 2019, në përbërje të këtij rrjeti janë 21 organizata dhe klube rinore të specializuara në fusha të ndryshme të shëndetit seksual dhe riprodhues, edukimit, shërbimeve sociale dhe shëndetësore, të drejtave të njeriut, punës në komunitet dhe punës me grupet e marginalizuara dhe në nevojë. Organizatat janë rrjetëzuar me njëra – tjetrën, duke zbatuar aktivitete të ndryshme në nivel kombëtar dhe rajonal. Përgjatë zbatimit të programit rinor në vitin 2019, Observatori ka realizuar **anketime me 500 të rinj mbi njohuritë dhe perceptimet e tyre në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, në 5 Bashki të vendit** (Pogradec, Maliq, Krujë, Urë Vajgurore, Shijak). Gjetjet më interesante nga anketimet janë realizuar si factsheet mbi

njohuritë dhe perceptimet e të rinjve për sa i përket shëndetin seksual dhe riprodhues, SDGs dhe programeve bashkiake, në secilën bashki. Gjithashtu, përmes ekspertizës së Observatorit, janë hartuar **Plane aktivitetesh dhe buxhetore për të rinjtë në 4 Bashki** (Dibër, Lezhë, Pogradec dhe Maliq), duke dhënë sugjerime konkrete për iniciativat, programe që duhet të drejtohen nga bashkia duke marrë parasysh të gjitha kompetencat sipas Ligjit 75/2019 “Për rrinë”, Ligjit për qeverisjen lokale dhe Planit Kombëtar Veprimt për Rininë 2015-2020.

Observatori **monitoroi Deklaratën e Angazhimeve për të rinjtë**, e nënshkruar nga Bashkia e Tiranës që prej vitit 2015, duke analizuar më në detaje:


- Trefshimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për rrinë (nga 1% në 3%)



- Ngritjen e një instrumenti publik transparent që tregon iniciativat dhe sipërmarrjet rinore të mbështetura nga bashki
- Hapjen e Qendrave Rinore në zonat periferike të Tiranës
- Hyrjen në fuqi të Kartës së Studentit
- Krijimin dhe funksionimin e Bordit Rinor Këshillimor të Bashkisë Tiranë

Produktet e realizuara nga Observatori në programin e rinisë, gjenden në linkun: <https://observator.org.al/sq/publikime/>

Lufta ndaj ngacmimit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri



Studimi mbi “Lufta ndaj ngacmimit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri” u realizua në 21 shkolla pilot. Ky studim u bazua në gjetjet nga sondazhi kombëtar mbi ngacmimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në sistemin arsimor në Shqipëri. Nisma projektoi ndërhyrjen e saj duke u përqëndruar në tre nivele: zhvillimi i mekanizmave efektiv të shkollës në krijimin e mjedisit të sigurt shkollor (hartimin e politikave), ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere.

Në mënyrë të veçantë, qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të mbledh dhe të analizojë të dhënat për efektivitetin dhe efikasitetin e veprimit; të masa ndikimin dhe qëndrueshmërinë e veprimit në sistemin arsimor në Shqipëri. Pjesëmarrës në këtë studim ishin studentë, mësues, stafi i projektit dhe prindërit nga shkollat përfituese dhe shkollat jopërfituese.

Gjetjet ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në lidhje me ndikimin dhe ndryshimet e perceptuara për shkak të zbatimit të nismës, duke hedhur dritë mbi domosdoshmërinë e vazhdimin të nismave mbi fenomenin e bullizmit në sistemin arsimorë në Shqipëri.

Studimin e plotë mund t’a lexoni në linkun: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2019/07/HF24_Action-Impact-Study_Bullying_ENG.pdf.pdf

Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve



Në partneritet me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) u realizua nisma “Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët - Impakti i videoklipeve të këngëve”. Kjo iniciativë konsistoi në pilotimin dhe ngritjen e një instrumenti për të analizuar artin muzikor të videoklipeve të këngëve, duke vëzhguar çështjet e etikës.

Në kuadër të këtij projekti u ngrit një metodologji monitorimi e cila përfshinte kanalet TV që do të monitoroheshin, oraret e monitorimit si dhe një listë treguesish që targetoni si teksin e këngëve, ashtu dhe imazhet që transmetohen gjatë klipeve. Metodologjia u pilotuar për një periudhë 6-javore. Gjetjet dhe problematikat e evidentuara gjatë kësaj nisme janë përfshirë në një raport vlerësimi si dhe janë ndarë me stafin përgjegjës të AMA.

Për më shumë informacion rreth nismës mund të lexoni raportin në linkun: https://observator.org.al/wp-content/uploads/2020/02/Raporti_final-shqip_5.12.2019.pdf

» PARTNERËT E OBSERVATORIT

Kontributi i Partnerve

TITULLI I PROJEKTIT	PERIUDHA E ZBATIMIT	DONORI
Monitorimi i të drejtave të fëmijëve me fokus fëmijët jashtë shkolle në Shqipëri	January – December 2019	UNICEF
Zbatojmë normat - Ndryshojmë Mendësitë- Program Rajonal	Janar – Maj 2019	Un Women
Programi “Zëri i të Rinjve”	Janar – Dhjetor 2019	UNFPA
Lufta ndaj ngacmimit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri	Janar – Mars 2019	Këshilli Europës
Popkultura në median televizive dhe ndikimi tek adoleshentët. Impakti i videoklipeve të këngëve	Shtator – Dhjetor 2019	AMA